

V E N D I M
Nr.562, datë 9.10.1995

PËR SHITJEN E TRUALLIT TË NDËRMARRJEVE QË PRIVATIZOHEN

Mbi bazën e ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 dhe ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Shitja e truallit sipërfaqe e domosdoshme për ushtrimin e veprimëtarisë së ndërmarrjeve dhe objekteve që privatizohen të bëhet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe, sipas përcaktimit në autorizimin e kalimit të pronësisë të lëshuar për këtë qëllim për ndërmarrjen apo objektin përkatës.

2. Sipërfaqja e domosdoshme për zhvillimin e veprimëtarisë së ndërmarrjes ose pjesëve të ndara të saj përcaktohet mbi bazën e gentplanit ekzistues të ndërmarrjes duke hequr nga ajo sipërfaqe pjesë të panevojshme për funksionimin e ndërmarrjes.

Kjo sipërfaqe përcaktohet nga komisionet e vlerësimit të ndërmarrjeve apo objekteve, zyrat e urbanistikës dhe organi i financës në pushtetin lokal dhe miratohet nga Drejtoria e Shoqërive Publike dhe degët e saj në dikastere apo pushtetet lokale sipas përkatësisë së ndërmarrjes apo objektit që shitet.

3. Shitja e truallit është pjesë e kontratës së shitjes së ndërmarrjes apo objektit.

4. Në rastet e ndërmarrjeve ose objekteve të privatizuara mbi bazën e kërkesës së pronarit të objektit apo ndërmarrjes të lidhet kontratë shitjeje për truallin e ndërmarrjes. Shitja e truallit të bëhet nga organet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe sipas gentplaneve të ndërmarrjeve në dosjet e privatizimit. Në qoftë se pronari i objektit nuk dëshiron të blejë truallin e ndërmarrjes, atëherë vazhdon kontratën e qirasë së truallit me seksionin e financës përkatës.

5. Pagesa e truallit të ndërmarrjeve dhe objekteve që janë privatizuar ose do të privatizohen bëhet vetëm me lekë sipas çmimit në fuqi të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi